



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:214597

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06795262

**C.nr.4267/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.K. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Dukagjini" me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim u dëmit, jashtë seance, me datë 03.02.2025 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** së është tërhequr padia me numër C.nr.4267/2024, e paditësit M.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Dukagjini" me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen juridike për kompensimin e dëmit.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij av. B.M. pranë kësaj gjykate me datë 31.07.2024 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Dukagjini" me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

I autorizuari i tij, me parashtrësën e datës 31.01.2025 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë pasi që palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore në këtë çështje juridike.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore 03/L-006, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil**  
**C.nr.4267/2024, datë 03.02.2025**

**Gj y q t a r i**

**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.